


# TË LUMTUR

GJYKATA VENDI I DREJTËSISË



# PËR TË DREJTAT QË KEMI

# TOLERANCA, ELEMENT KRYESOR I DEMOKRACISË

ELDA (10), ESMA (11), ELIONA (10), ENESI (11), LYRA (11), OLTİ (10), REIS (11), SHKURTA (10)



## Demokratët e rinjë flasin për demokracinë në Kosovë

Nëse flasim për demokracinë, mendojmë se është më e drejtë të përmendim se si ka qenë demokracia në kohët e lashta e si është tani. Po ashtu, është e rëndësishme të cekim cili është kuptimi i demokracisë si dhe pse është e nevojshme që vendet të kenë udhëheqje demokratike.

Demokracia rrjedh nga fjala greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje. E tërë kjo i bie se demokracia është qeverisje e popullit. Demokracia në Kosovë dhe në vendet e tjera ka pësuar ndryshime nga demokracia e kohëve të lashta.

Ato dallime janë: në kohët e lashta gratë nuk kanë pasur të drejta të barabarta me burrat, për shembull të drejtën e të punësuarit etj. Por një ditë, gratë të lodhura nga ajo gjendje jo shumë e mirë menduan të protestonin për të drejtat e tyre. Përmes protestës, gratë i shprehën pakënaqësitë e tyre ndaj këtij sistemi jo të drejtë qeverisës. Me kalimin e viteve dhe me shumë mund, gratë arritën të fitojnë të drejta të barabarta, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e votimit.

Tash në këto kohë, këtë të drejtë e gëzojnë të gjithë qytetarët si: myslimanët, krishterët, ortodoksit dhe njerëzit me nevoja të veçanta. Kjo e drejtë fitohet pasi të arrijmë moshën 18 vjeçare.

Demokracia është sistem i cili iu mundëson të gjithë qytetarëve të jenë pjesëmarrës në bashkëvendosje.

Si arrihet kjo?

Kjo është e mundur sepse Kosova është një ndër vendet ku demokracia zhvillohet gjatë gjithë kohës, sepse pothuajse të gjitha elementet e demokracisë janë të pranuar dhe respektohen nga të gjithë qytetarët e Kosovës. Vendi ynë Kosova ka demokraci përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese është e ndarë në sistemin parlamentar dhe presidencial. Ne qeverisim vendin përmes demokracisë përfaqësuese. Pra, vendimet merren nga përfaqësuesit që ne i njohim si deputetë. Ne votojmë përfaqësuesit, ndërsa përfaqësuesit na përfaqësojnë neve.

Në disa vende të tjera ka demokraci të drejtpërdrejtë, që do të thotë se vendimet merren direkt nga populli. Kjo do të thotë se demokracia ka forma të ndryshme të të shprehurit, të të menduarit, të qeverisjes, etj.

Ne mendojmë se nëse nuk iu tregojmë prejardhjen e demokracisë, artikulli ynë do të dukej paksa i mangët, prandaj shpresojmë se lexuesit tanë do të marrin informata të reja mbi demokracinë.



Autorët e artikullit




Të gjithë jemi të barabartë



Institucioni i Gjykatës Themelore



E drejta e votës së fshehtë



Qeveria e ushtron pushtetin Ekzekutiv



Interesimi ynë për të marrë më shumë informacione



Puna na bën të jemi më të zhvilluar në çdo aspekt

## PUSHTETI NDAHET NË TRI PJESË

BESART (11), DION (11), BLEART (10), ERLINDA (11), DIARI (11), ADRIANA (11), ANDUENA (11),  
DJELLON (10)



### Sot, ne gazetarët e Kuvendit të Kosovës do të jemi pjesë e vizitës që organizohet nga Punëtorja për Demokraci Demos-ti

Pushtetin në demokraci ndryshe e quajmë fuqi. Ne kemi tri pushtete të cilat punojnë ndaras, por janë të lidhura dhe bashkëpunojnë në mes vete. Ato pushtete janë: pushteti Legjislativ, që e ushtron Kuvendi, pushteti Ekzekutiv që e ushtron Qeveria, si dhe pushteti gjyqësor, që ushtrohet nga Gjykatat. Pushteti Legjislativ është një pushtet me shumë përgjegjësi. Këto përgjegjësi i kanë personat, të cilët ne si qytetarë i kemi zgjedhur për të qenë përfaqësuesit tanë, e që ndryshe i quajmë deputetë. Në Kosovë kemi 120 deputetë të partive të ndryshme. Kryetar i Kuvendit është ai i cili i udhëheq mbledhjet ose seancat plenare. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka tri funksione e ato janë: funksioni përfaqësues sepse deputetët janë përfaqësuesit e popullit tonë. Ka funksion legjislativ, sepse deputetët përveçse miratojnë ligje, ata kanë të drejtën edhe t'i propozojnë ato ligje. Funksioni i tretë është funksioni i kontrollit, ku Kuvendi si institucioni më i lartë shtetëror, e kontrollon punën e Qeverisë.

Qeveria është vendi ku punon Kryeministri dhe ministrat. Sikurse institucionet tjera edhe Qeveria ka rëndësinë e saj. Ne në Kosovë kemi ministri të ndryshme e ato janë: Ministria e Bujqësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe të Brendshme, Mi-

nistria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e shumë ministri të tjera. Qeveria e ka për detyrë t'i propozojë ligjet në Kuvend dhe t'i zbatojë ato. Gjykatat janë ato të cilat merren me personat të cilët dyshohet se kanë shkelur ligjin.

Në Kosovë, kemi tri lloje të gjykatave: Gjykatat Themelore, që gjenden në çdo komunë të Kosovës, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme që gjenden në kryeqytetin e Kosovës, pra në Prishtinë. Ne nxënësit e klasës V-5, sot kemi për ta vizituar Kuvendin e Kosovës, ku do të mësojmë më shumë për punën që e bëjnë deputetët dhe detyrat e tyre. Ne urojmë që të gjithë fëmijët e tjerë sikurse ne, të kenë mundësi ta vizitojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës.



Gazetarët e Kuvendit të Kosovës

# NE, PJESË E ZGJEDHJEVE

YLLI (11), ERION (10), ALBION (11), AIDA (10), ARGJENDA (10), ERZA (10), MIMOZA (10)

## Ne sot mësuam për zgjedhjet dhe llojet e tyre

Ne si fëmijë që jemi, bëjmë zgjedhje në jetën e përditshme. Ne së bashku me mësuesen zgjedhim lëndët mësimore, të cilat duam t'i mbajmë në orët e para. Ne po ashtu zgjedhim kryesinë e klasës, shokët apo shoqet, ushqimin që na pëlqen etj. Mirëpo, kur të mbushim moshën 18 vjeçare mund të marrim pjesë në procesin zgjedhor. Pra, do të jemi pjesë e rëndësishme e një procesi vendimmarrës për vendin tonë. Në këtë proces, ne do t'i zgjedhim udhëheqësit ose përfaqësuesit tonë. Prandaj, duhet të kemi kujdes se kë e votojmë. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: lokale (komunale) ku e zgjedhim kryetarin e komunës, si dhe zgjedhjet qendrore (parlamentare) ku i zgjedhim deputetët. Ne të gjithë duhet të votojmë, sepse ne bëjmë ndryshimin. Ne do të jemi pjesë e zgjedhjeve.



Autorët e artikullit



Ne mund të zgjedhim çdo ditë



Të gjithë duhet të votojmë



Grupi duke punuar për artikullin



Unë kam të drejtë të votoj pavarësisht gjinisë sime



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPËTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:

Tel: +381 38 704 560

E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)

Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

SHFMU „Nazim Gafurri“

Klasa: V-5

Vendi: Prishtinë